



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.1322/4 prot.

Datë 05.05.2026

**V E N D I M**

**Nr. 587/2026**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 05.05.2026 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit “*E hapur, e thjeshtuar*” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “ *Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)*”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sh.A.
- Ankimues:** “Bajro Bros” SHPK me NIPT M113130290 dhe adresë: Rr. Ndre Mjeda, Kompleksi rezidencial Magnet , Pallati Lura, njesi sherbimi nr.1017 , Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Pogradec Sh.A, me adresë: Rruga e Gurasit , Guras Pogradec.
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi nr. 285, datë 19.05.2021 i Këshillit të Ministrave

*“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 23-04-2026 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “Furnizim – Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.

II.2. Në datën 29.04.2026 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është paraqitur ankesa me numër online të ankesës A/2026/6595 dhe protokolluar me tonën me nr. 1322/2026, datë 29.04.2026 e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Bazuar në pikën 2 të nenit 112, të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) për ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë.

II.4. Në datë 24.04.2026 autoriteti kontaktor ka publikuar shtojcën me modifikimet e dokumentave të tenderit si më poshtë vijon:

*“Ndryshimi do të jetë si më poshtë vijon:*

### ***ISHTE***

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencen Profesionale të vlefshme për kategorite:*

*NP-2 (Ndërtim civile dhe industriale)*

*NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre).*

### ***BEHET***

*Operatori ekonomik duhet të paraqesë Liçencen Profesionale të vlefshme për kategorite:*

*NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre).*

*Natyra teknike e instalimit përfshin nderhyrje në rrjetin elektrik dhe elementet e struktues, është e nevojshme që Operatori ekonomik të disponojë kualifikime dhe Licenca specifike për instalime mekanike, dhe të garantojë zbatimin e standarteve të sigurisë dhe cilësisë.”*

II.5. Nëpërmjet shkresës nr. 395 datë 30.04.2026 protokolluar me tonën me nr.1322/1 datë 04.05.2026, është përcjellë nga autoriteti kontraktor trajtimi i ankesës së operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK. Referuar shkresës të sipërcituar të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe e ka njoftuar atë, se ka vendosur refuzimin e ankesës.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

#### Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK mbi kriteret e përcaktuar në dokumentet e tenderit konkretisht për pikën 2.3.3 “*Operatori ekonomik duhet të paraqese Liçencen Profesionale të vlefshme për kategorite: NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre).*”, për të cilat ka kërkuar heqjen e saj nga kerkesat për kualifikim me arsyetimin se “*si kerkese që është e paligjshme e cila cenon konkurrencen e ndershme duke privuar pjesëmarrjen në gare të shumices dermuese të OE...Duke parë listën e llojeve të kondicionereve, shihet qartë që kerkohen kondicionere MURAL dhe TOKESOR, si dhe KOLLONE, montimi i të cilëve nuk ka asnjë lidhje me licencën NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre), sepse nuk ka lidhje me impjante hidro sanitare apo termosantare, pra MONTIMI I TYRE MUND TË BEHET NGA TEKNIKE TË THJESHTE, OSE MAKSIMUMI ME ASISTENCEN E NJE TEKNIKU TË KUALIFIKUAR PËR KONDICIONERE*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 8 “*Formular i i kriterëve të përzgjedhjes/kualifikimit*”, të dokumenteve të tenderit, pika “2.3. Kapaciteti teknik” parashikon pikën 2.3.3 si më poshtë vijon:

[...]

#### **Ishte**

“2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqese Liçencen Profesionale të vlefshme për kategorite:*

*NP-2 (Ndërtime civile dhe industriale)*

*NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre).*”

#### **Behet**

“2.3.3 *Operatori ekonomik duhet të paraqese Liçencen Profesionale të vlefshme për kategorite:*

*NS-2 (Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre).*

*Natyra teknike e instalimit përfshin nderhyrje në rrjetin elektrik dhe elementet e struktues, është e nevojshme që Operatori ekonomik të disponojë kualifikime dhe Licenca specifike për instalime mekanike, dhe të garantojë zbatimin e standarteve të sigurisë dhe cilesisë.*”

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.1.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.1.5. Në nenin 77 pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, shprehimisht thuhet se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.”

Në nenin 40, pika 5 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të VKM Nr. 285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet se:

“5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose c) fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose ç) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit..”.

III.1.6. Në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e ndryshuar, Lidhja 4 “Klasifikimi paraprak i shoqërisë ndërtimore sipas nivelit për cdo kategori punimesh zbatimi” është përcaktuar niveli i punimeve të kryera për cdo kategori punimi si vijon:

**LIDHJA 4**  
**KLASIFIKIMI PARAPRAK I SHOQËRIVE NDËRTIMORE SIPAS NIVELEVE PËR**  
**ÇDO KATEGORI PUNIMESH ZBATIMI**

<b>NIVELI I SHOQËRISË</b>	<b>SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI</b>
<b>A (edhe për herë të parë)</b>	<b>0- 20 milion lekë</b>
<b>B</b>	<b>21- 50 milion lekë</b>
<b>C</b>	<b>51 – 100 milion lekë</b>
<b>D</b>	<b>101 – 200 milion lekë</b>
<b>E</b>	<b>201 – 400 milion lekë</b>
<b>F</b>	<b>401 – 800 milion lekë</b>
<b>G</b>	<b>mbi 800 milion lekë</b>

Në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar, jepen shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, ku përcaktohet:

*Lidhja 2*

*Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit në ndërtim.*

**PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI**

*N.P –1 Punime gjërmimi në tokë.*

*N.P –2Ndërtime civile dhe industriale.*

*N.P –3Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.*

*N.P –12Punime të inxhinierisë së mjedisit.*

**PUNIME SPECIALE NDËRTIMI**

*N.S-2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina,lavanteri, mirëmbajtja e tyre.*

*N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).*

*N.S.-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.*

*N.S –8 Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.*

*N.S –9 Punime strukturore speciale.*

*N.S –10 Shtresa dhe mbistrukturaspeciale.*

*N.S -12 Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.*

*N.S -13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.*

*N.S –14 Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.*

*N.S –18 Punime topogjeodezike.*

*N.S.-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë*

### ***SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE***

*N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavaxteri, mirëmbajtja e tyre Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavaxterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.

Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimi e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së.

Në rastin konkret, lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK, për modifikimin klasifikimit të licencave profesionale të shoqërisë konkretisht NS-2 (Impiante hidrosanitare dhe mirembajtja e tyre), KPP nisur dhe nga procesverabli i argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve autoriteti kontraktor si në argumentimin e vendosjes së këtyre kërkesave ashtu edhe në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës nuk ka shpjeguar në mënyrë të konkretizuar se për cilat zëra/artikuj të preventivit duhen kryer këto punime/instalime që të kërkohet kjo kategori licencese në mënyrë që pas ballafaqimit me instalimet ose punimet e nevojshme të zërave/artikujve të kryhet verifikimi mbi nevojën për paraqitjen së këtyre licencave apo jo. Akoma më tej në kthimin e përgjigjes për trajtimin e ankesës KSHA e autoritetit kontraktor

nuk e ka lidhur nevojën për licencën NS-2me argumentimin se ka punime të instalim/montimit dhe ndërhyrje në rrjete elektrike dhe elementë mbështetës, por nuk ka specifikuar konkretisht se për cilët zëra dhe në çfarë niveli janë këto ndërhyrje në rrjete elektrike të pa përshkruar në dokumentat e tenderit. KPP, nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, dhe referuar dhe procedurës e cila është e hapur e thjeshtuar, arrin në konkluzionin se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për të modifikuar kriterin pasi edhe sipas përkufizimit të VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, e nryshuar, të sipërcituar e gjen të pa justifikuar kërkesën e autoritetit kontraktor për pikën e licensës së subjektit për NS-2 “(Impiante hidro - termosantare dhe mirembajtja e tyre)”, dhe nuk ka argumentuar në lidhje me nivelin e kërkuar që i referohet zërave që do të prokurohen dhe volumit specifik të tyre.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e kriterëve dhe/ose specifikimeve teknike krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit duhet të kenë në vëmendje faktin se hartimi i tyre duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Sa më lart arsyetuar, referuar kriterit 2.3.3 autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e saj.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikes 1 dhe 3 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

## Vendos

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me nr. REF-82955-04-22-2026, me objekt: “Furnizim –Montim pajisje zyre (kondicionere+karrige)”, me fond limit 1,299,834.00 lekë (pa tvsh), parashikuar për tu zhvilluar me datë 08-05-2026 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Pogradec Sh.A.

2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet sipas konstatimeve të mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimes "Bajro Bros" SHPK.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

